REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
DREJTORIA E TË ARDHURAVE DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Nr. 4314 **Prot.** **Rrogozhinë, më** 14 / 10 **2025**

Lënda: Drafti i Parë për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Rrogozhinë

Bashkangjitur po j'u dërgojme "Draftin e Parë" për prezantimin e Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore për Bashkinë Rrogozhinë për Vitin 2026.

Konc:
Marsida THARTORI

KRYETAR
Edison MEMOLLA

Në mungesë dhe me urdhër
N/Kryetar

Andi PROSHKA

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email: brrogozhine@gmail.com

CamScanner

DRAFT "SISTEMI I TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE 2026"

BASHKIA RROGOZHINË

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagjia Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email: brrogozhine@gmail.com

CamScanner

PËRMBLEDHËSE:

a. PROCESI I HARTIMIT TË PAKETËS FISKALE, BAZA LIGJORE	faqe 3-4
b. KUADRI LIGJOR	faqe 5
c. TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL	faqe 6
d. TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME	faqe 6-7
e. TAKSA E NDËRTESËS	faqe 7-10
f. TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE	faqe 10-11
g. TAKSA MBI TRUALLIN	faqe 12
h. TAKSA E FJETJES NË HOTEL	faqe 13
i. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË	faqe 14-16
j. TAKSA E KALIMIT E SË DREJTËS SË PRONËSISË	faqe 16-17
k. TAKSA E TABELËS	faqe 17-19
l. TAKSA E MJETEVE TË PËRDORURA	faqe 19
m. TË ARDHURA PJESORE NGA TAKSA E RENTËS MINERARE	faqe 20
n. TARIFË PËR INFRASTRUKTURË NËN-TOKËSORE	faqe 20
o. TARIFA E PASTRIMIT DHE SHËRBIMIT	faqe 21-25
p. TARIFAT E URBANISTIKËS	faqe 25-26
q. TARIFA E ZËNIES SË HAPËSIRËS PUBLIKE PËR ZONËN E PLAZHIT	faqe 26-28
q. TARIFË E TREGUT TË LIRË	faqe 28
r. TARIFA E LICENSIMIT TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE DHE MALLRAVE	faqe 29
s. TARIFA E PARKIMIT TË AUTOMJETEVE	faqe 29-30
t. TARIFA BAZË TË LËNDËS DRUSORE NË KËMBË, PËR LLOJET INDUSTRIALE	faqe 30-31
u. TARIFA BAZË PËR VADITJEN E TOKAVE BUJQËSORE	faqe 31
v. TARIFA BAZË PËR KULTIVIMIN E PESHKUT NE REZERVUAR	faqe 31
x. NIVELET E TARIFËS PËR DHËNIE LICENSE PËR TREGTIMIN E NAFTËS BRUTO DHE NËN-PRODUKTEVE TË SAJ	faqe 32
z. KUNDRAVAJTJET DHE MASAT E GJOBAVE	faqe 32-34
zh. GJOBA PËR MOSSHLYERJE NË AFAT TË DETYRIMIT	faqe 34-35

CamScanner

SISTEMI TAKSAVE DHE TARIFAVE VITI 2026

Reforma territoriale e aplikuar në vitin 2015, solli ndryshime edhe për kufijtë territorial të Bashkisë Rrogozhinë, duke përfshirë brenda saj territore tërësisht të ndryshme nga përbërja administrative, kulturore, sociale etj. Lidhur me këto ndryshime, lindi domosdoshmëria e krijimit të raporteve ndërmjet zonave në fushat e ndryshme administrative, në ruajtjen e këtyre traditave, territoreve produktive në aspektin bujqësor, në ruajtjen dhe mirëadministrimin e pyjeve, kullotave etj. Gjithashtu, për të qenë sa më pranë banorëve si dhe për të krijuar mundësi të barabarta të përfitimit të shërbimeve publike, u studiuan me prioritet llojet dhe nivelet e taksave dhe tarifave. Tashmë Bashkia Rrogozhine në tërësinë e saj, është përkushtuar për arritjen e objektivave, për realizimin e të ardhurave si dhe në shpërndarjen sa më të drejtë të buxhetit për çdo NJ/A. Sipas Ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", **Bashkia Rrogozhinë kufizohet gjeografikisht nga lindja me Bashkinë Tiranë, në perëndim nga Deti Adriatik, në veri nga Bashkia Kavajë, në jug-lindje nga Bashkia Peqin dhe në jug nga Bashkia Lushnje. Bashkia Rrogozhinë ka një sipërfaqe prej 223.5 km² tokë, me një vijë bregdetare prej 15 Km. Përbëhet nga Qyteti Rrogozhinë dhe 4 Njësi Administrative që janë: Nj/A. Gosë, Nj/A. Lekaj, Nj/A. Kryevidh dhe Nj/A. Sinaballaj, me një numër prej 39 fshatrash. Numri i familjeve në Bashkinë Rrogozhinë është 11.349 dhe me popullsi 42.732 banorë.**

Nr.	Qyteti/Njësia Administrative	Lagja/Fshati
1	Qyteti Rrogozhinë	Lagja Nr 1,Lagja Nr.2
2	Nj.A. Sinaballaj	Sinaballaj, Hasdushk, Met-hasanaj, Hamenraj, Kocaj, Thartor, Rrostej, Fliballie, Demarke.
3	Nj.A. Gosë	Gosë Qendër, Kërcukaj, Gosë e Madhe, Gosë e Vogël, Kalush, Ballaj, Vilë Bashtovë.
4	Nj.A. Lekaj	Luz i madh, Shkozet, Lekaj, Harizaj, Kryeluzaj, Gërmenj, Okshtun, Zanbishë, Mushnikë, Mlik.
5	Nj.A. Kryevidh	Domen, Kazie, Spanesh, Stërbeg, Spille, Greth, Shardushk, Kryevidh, Rreth Greth, Ballaj, Zhabjak, Patk-Milot.

CamScanner

Procesi i Hartimit të Sistemit të Taksave dhe Tarifave.

Për hartimin e këtij dokumenti janë angazhuar drejtuesit dhe specialistët në Bashkinë Rrogozhinë;

- Drejtoria e Financës
- Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
- Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Mardhënieve me Publikun.
- Drejtoria e Politikave Urbane.
- Drejtoria e Shërbimeve/Mirëmbajtjes dhe Transportit
- Drejtoria e Bujqësisë
- Drejtoria e Shërbimit Social
- Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit.
- Drejtoria e Arsimit, Turizmit, Kulturës dhe Sportit.
- Gjendja Civile.
- Policia Bashkiake.
- Administratorët e Njësive Administrative.

Hartimi kalon nepërmjet etapave si më poshtë;

- Ngritja e grupit të punës.
- Përcaktimi i bazës ligjore dhe prioriteteve strategjike të zhvillimit.
- Konsultimi propozimeve me banorët dhe grupet e interesit (bizneset).
- Miratimi nga Keshilli Bashkiak, Prefektura dhe më pas publikimi.

Çfarë prezanton Sistemi i Taksave dhe Tarifave?

Prezanton propozimet për sistemin e ri të taksave dhe tarifave që ne duam të zbatojmë për periudhën në vazhdim, duke qënë në linjë dhe në zbatim me prioritetet e Strategjisë së Zhvillimit në Bashkisë Rrogozhinë dhe Planit të Zhvillimit të Territorit. Propozimet konsistojnë në përmirësime teknike dhe proçeduriale, për përgatitjen e një pakete fiskale të integruar, gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë. Gjithashtu synojm nje taksim dhe tarifim sa më të drejtë për të gjithë qytetarët e Bashkisë Rrogozhinë dhe atyre që ushtrojnë aktivitet privat pranë territorit të Bashkisë tonë.

Çdo taksë dhe tarifë do të detajohet duke patur në konsideratë elementët;

- Taksim në bazë të ligjeve.
- Tarifim i drejtë dhe i mbështetur në kosto.
- Klasifikimi dhe përcaktimi i taksave dhe tarifave që aplikohen për të gjitha kategoritë, duke nisur nga ato familjare dhe biznesi.
- Aplikimi i lehtësirave fiskale për grupe të caktuara taksapaguesish të përjashtuar, siç parashikon ligji.

CamScanner

Kuadri ligjor dhe nënligjor

- Ligji Nr. 9632, Datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 139/2015, Datë 17.12.2015 "*Për vetqeverisjen vendore*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 68/2017 "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 8438, Datë 28.12.1998 "*Për tatimin mbi të ardhurat*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9975, Datë 28.7.2008 "*Për taksat kombëtare*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9920, Datë 19.5.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10279, Datë 20.05.2010 "*Për kundravajtjet administrative*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9723, Datë 3.5.2007 "*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10081, Datë 23.2.2009 "*Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10304, Datë 15.7.2010 "*Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë*".
- Ligji Nr. 93/2015 "*Për turizmin*", i ndryshuar, VKM 649, Datë 16.10.2024
- Ligji Nr. 9482, Datë 03.04.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10 465, Datë 29.9.2011 "*Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 8450, Datë 24.2.1999 "*Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre*", i ndryshuar.
- Ligji. Nr. 9385, Datë 4.5.2005 "*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9693, Datë 19.3.2007 "*Për fondin kullosor*", i ndryshuar.
- Ligji Nr.8744, Datë 22.2.2001 "*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10296, Datë 08/07/2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10463, Datë 22.9.2011 "*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 152/2015, Datë 21.12.2015 "*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 64/2012, Datë 31.05.2012 "*Per Peshkimin*", i ndryshuar.

CamScanner

1. TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

Baza Ligjore: Ligji Nr. 8438, Datë 28.12.1998 "*Për Tatimin mbi të ardhurat*" , i ndryshuar, Kreu III. Ligji Nr. 9632, Datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, Kreu III, Neni 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19.

Struktura e ngarkuar për arkëtimin e tatimit: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Administrata Tatimore Qëndrore: transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet dhe për shërbimin që kryen merr një komision, i cili është në masën 1% (një për qind) dhe derdhet në llogari të Administratës Tatimore Qëndrore.

Struktura e ngarkuar për kryerjen e akt-rakordimeve: Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik është përgjegjëse për rakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore, Durrës.

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i madh se 14.000.000 (katermbedhjete milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

- Baza e taksës/tatimi: Kështet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatim-paguesit me qarkullim vjetor mbi 14.000.000 lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë.
- Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatim-paguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela 1. Nivelet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Shkalla tatimore	**Njësia**	**Shkalla tatimore**	
		Nj.A.Rrogozhinë	**Nj.A të tjera**
A. Me qarkullim vjetor nga 0 – 14.000.000 lekë	lekë/vit	0	0
B. Me qarkullim vjetor mbi 14.000.000 lekë	lekë/vit	15% e fitimit	15% e fitimit

Mënyra e pagesës: Tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore kështet tre-mujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, brenda datës 20 prill, për muajt: janar, shkurt e mars; brenda datës 20 korrik, për muajt: prill, maj e qershor; brenda datës 20 tetor, për muajt: korrik, gusht e shtator; dhe brenda datës 20 dhjetor, për muajt: tetor, nëntor dhe dhjetor.**(Debitor)**

2. TAKSA MBI PASURITË E PALUAJTSHME

"Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari,

CamScanner

sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie".

Kjo taksë bazohet ne Ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar me Ligjin Nr 142/2015, datë 17.12.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632..." .

Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie. "Përdorues", njihert individi, personi fizik ose personi juridik, që ka në përdorim ndërtesën/ njësinë pronësore për qëllime banimi, veprimtarie ekonomike apo për veprimtari joekonomike, pavarësisht nga fakti nëse kjo ndërtesë/njësi pronësore ka titull pronësie ose jo.
Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi ndërtesën
- Taksa mbi truallin

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë duhet të njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë, për vërtetim pronësie njohin vërtetimin e pronësisë, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Në rastin e mungesës së dokumentacionit të vërtetimit të pronësisë, bashkia vendos madhësinë e sipërfaqes së tatueshme, bazuar në vendimin e komisionit të verifikimit të pasurisë së paluajtshme. Organet e pushtetit vendor ngrenë komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme, në rast mungese të dokumentacionit ligjor. Detyrat dhe funksionet e këtij komisioni përcaktohen me vendim të këshillit të bashkisë.

A.2.1.1 Taksa mbi ndërtesat.

Aneksi 1

Tabela 2: Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qellim banimi, Bashkia Rrogozhine është 41.000 lekë/m^2.

CamScanner

			Qyteti Rrogozhinë		Cmimi në lek	
Nr.	**Nivelet e taksës sipas kategorive**	**Njësia**	**Vlera e referencës**	**Shkalla në % e taksës**	**Rrogozhinë**	**Nj. administrative**
	Ndërtesa Banimi		41000 lekë/m²			
a **a/1**	Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori do të përfshihen edhe ndërtesa tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim, tregtim ose/edhe shërbime me pakicë. (41000x1.5x0.2%) Për Nj/A. **Reduktohet -30%** Ndërtesa në vijën bregdetare Spille	Lekë/m²/vit	41000x1.5= 61500lekë/ m²	0.2%	123 123	86
b	Çmimi për m² sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar e bodrum është 70% e çmimit të sipërfaqes së banimit (41000 x 70% x 0.2%)	Lekë/m²/vit	41000x70% = 28700lekë/ m²	0.2%	57	40
c	Çmimi për m² sipërfaqe ndërtimi për parkim të hapur,pishinë e hapur, ambjente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbolli, minifutbolli, basketbolli, volejbolli, tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme, etj; është 30% e çmimit të sipërfaqes së banimit (41000 x 30% x 0.2%)	Lekë/m²/vit	41000x30% =123000lekë/m²	0.2%	25	17.5
ç	Çmimi për m² sipërfaqe ndërtimi të destinuar për veprimtari industriale si: prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteveapo produkteve të ngjashme industrial, si: fabrika, magazine, depo, silos, magazine frigoferike, të produkteve ushqimore (përjashtuar ato të njësive të tregtimit dhe të shërbimit), si dhe objekte të tjera të ngjashme me to, është 50% e çmimit të sip.banesës (41000 x 50% x 0.2%)	Lekë/m²/vit	=41000x50 %=20500lekë/m²	0.2%	41	29
d	Çmimi për m² sipërfaqe ndërtimi që përdoret për bujqësi dhe blektori apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinimin e ruajtje së produkteve bujqësore e blektorale është 30% e çmimit të sip. banesës	Lekë/m²/vit	=41000x30 %=12300lekë/m²	0.2%	25	17.5
dh	Çmimi për m² për ndërtesat që përdoren, shfrytëzohen për banim është 0.05% e çmimit të referencës 41000 x 0.05%. **(NJ/A – 35%)**	Lekë/m²/vit	=41000x50 %=20500lekë/m²	0.05%	20.5	13
e	Çmimi për ndërtesat e privatizuara me Ligjin Nr. 7652, Datë 23.12.1992 "Per privatizimin e ndërtesave shtetërore" i ndryshuar, çmimi për m² është 70% vetëm në shitjen e parë(41000 x 70% x 0.05%)	Lekë/m²/vit	=41000x70 %=28700lekë/m²	0.05%	14	10

CamScanner

ë	Çmimi për të gjithë sipërfaqen ndërtimore për të cilën zhvilluesi është i paisur me leje për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim, por nuk ka arritur të përfundoj brenda afateve.	Lekë/m²/ vit	=55654x30 %=16696lekë/m²	0.05 %	8	5.5
f	Çmimi për të gjithë sipërfaqen ndërtimore për të cilën zhvilluesi është i paisur me leje për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike, por nuk ka arritur të përfundoj brenda afateve.	Lekë/m²/ vit	55654x30% =16696Lekë /m²/vit	0.2%	33	23

Baza e taksës: Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kategoritë dhe nënkategoritë	% e bazës së taksës
Për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim	0.05%
Për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike	0.20%
Për sip. ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundoj atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje	30% e shkallës së taksës përkatëse

Niveli i taksës mbi ndërtesat: Niveli për kategoritë dhe nënkategoritë, nivelet treguese të taksës mbi ndërtesën prezantohen si më poshtë vijon.

Në kategorinë "Ndërtesa Banimi", përfshihen:

- Të gjitha hapësirat që përdoren për qëllim jofitimprurës nga qytetarët vetëm për qëllim banimi.
- Ndërtesa në pronësi të shoqërive të ndërtimit të pashitura, por të hipotekuara si ndërtesa banimi.
- Ndërtesa të dyta banimi.

Në kategorinë "Ndërtesa per biznes", përfshihen:

1) "Ndërtesa për tregti dhe shërbime"

- Ndërtesa për shërbime tregtare, administrative etj të ngjashme me to: Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat, hotele, motele, stabiliment turistike, shtëpi pritje, turizëm familje, qëndra biznesi, pika karburanti, magazina, depo, banka, zyra, farmaci, klinika, spitale, maternitete, qëndra shëndetësore të të gjitha specialiteteve, stadiume, komplekse sportive si palestra, fitnes, pishina të hapura e të mbyllura dhe njësi tregtare dhe shërbimi të çdo lloji etj. të ngjashme me to.

2) "Ndertesa per veprimtari industriale/prodhuese"

CamScanner

- "Ndërtesa per veprimtari industriale/prodhuese" do të kuptojmë të gjitha ndërtesat në të cilat ushtrohet aktivitet prodhues si përpunim duralumini, metalesh, druri, tapecierie, letre, kartoni, plasmasi, tulla, tjegulla, blloqe banimi, furra gëlqereje, prodhime ushqimore, furrë buke, prodhim konfeksionesh, prodhim dhe përpunim vajrash, nafte etj., shtypshkronja, prodhim dhe përpunim produktesh farmaceutike dhe të ngjashme me to.

Për ato kategori ndërtesash banimi të cilat janë të regjistruara si seli të subjekteve tregtare, taksa e pasurisë përllogaritet dhe paguhet si "Ndërtesa per biznes", sipas rastit të ushtrimit të veprimtarisë duke u përjashtuar nga Kategoria "Ndërtesa banimi".

Detyrimi për pagesë: Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor. Drejtoria e të Ardhurave kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër.

Përjashtime: Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

a) pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jo fitimprurëse;
b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
e) strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";
ë) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;
f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:
Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik pranë Bashkisë Rrogozhinë si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.

Dokumentacioni që dorëzohet për të përfituar përjashtimin nga taksa e ndërtesës
Subjektet familjarë që përjashtohen nga taksë e ndërtesës depozitojnë pranë Njësisë Administrative ku kanë vendbanimin, dokumentacionin përkatës që vërteton se:

a. marrin pension pleqërie/social;
b. janë kryefamiljarë që kanë në përbërje të familjes vetëm pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre të të paaftë për punë;
c. trajtohen me ndihmë ekonomike;

CamScanner

d. kopje të dokumentit ku banojnë që provon se janë pronarë apo përdorues të pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumentet të pronësisë, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës etj, kopje të kontratës /librezës/faturës së abonentit kryefamiljarë që bën kërkesën për përjashtim.

A.2.1.2 TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Përkufizimi: "Tokë bujqësore" është toka e përcaktuar si e tillë në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurisë.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularit nr.6, aktit të pronësisë, çertifikatës së regjistrimit të tokës.

Niveli i taksës mbi tokën bujqësore paraqitet si më poshtë:

Kjo taksë bazohet ne Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar me Ligjin Nr. 142/2015, date 17.12.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.252, date 22.01.2016)

Tabela 3. Niveli i taksës mbi tokën bujqësore

Klasifikimi sipas kategorisë së tokës bujqësore	Nj. e matjes	Niveli Taksës	Propozimi-30%
I	lekë/hektar/vit	5600	3920
II	lekë/hektar/vit	4900	3430
III	lekë/hektar/vit	4200	2940
IV	lekë/hektar/vit	3600	2520
V	lekë/hektar/vit	3000	2100
VI	lekë/hektar/vit	2400	1680
VII-X	lekë/hektar/vit	1800	1260

Detyrimi për pagesë: Detyrimi për taksën mbi token bujqësore është vjetor. Detyrimi llogaritet nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
"Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës pranë Bashkisë ku ndodhet toka".
Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.
Taksa e mbledhur në mbështetje të këtij ligji paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.
Pagesat e taksës së tokës bujqësore do të kryhen dhe përllogariten në masën 70% të vlerës sipas kategorisë së tokës bujqësor kur paguhen brenda datës 30 Mars të vitit pasardhës.

CamScanner

Ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë dhe Sektori Kadastrës, për vlerësimin e kategorisë së tokës si dhe saktësimin dhe verifikimin e periudhës së mbjelljes me kultura drufrutore dhe vreshtari, për çdo fermer/fermë.
Ngarkohet sektori i Kadastres te saktësoje (AMTP) Aktin e marrjes se tokes ne pronesi sipas personave, duke pasqyruar dhe ndryshimet e herëpashershme e ia përcjell këtë informacion Drejtorisë së të Ardhurave she Zhvillimit Ekonomik për llogaritjen e detyrimit.
Klasifikimi sipas kategorive te tokes bujqesore behet nga strukturat e Ministrise se Bujqesise, Zhvillimit Rural dhe Administrimit te Ujrave.

CamScanner

A.2.1.3 Taksa mbi truallin

Përkufizimi: Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë njësisë ku ndodhet trualli.
Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Taksa e mbledhur, paguhet në buxhetin e Bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.
Pjesa e truallit mbi te cilin eshte ndertuar taksohet vetem si takse ndertese ndersa si truall taksohet pjesa qe mbetet.
Baza e taksës: Është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.
Niveli i taksës mbi truallin paraqitet si më poshtë:

Tabelë 4. Niveli i taksës mbi truallin

	Vlera e taksës në lekë/m²/vit	
Lloji taksës	**Për qëllime biznesi**	**Për Banim**
A. Taksë trualli	12 lekë/m²	0.14 lekë

Kjo takse bazohet ne Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar me Ligjin Nr. 142/2015, date 17.12.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.252, date 22.01.2016)

Detyrimi për pagesë: Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Drejtoria e të ardhurave kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër.

Deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë ose vetdeklarimit të sipërfaqes së truallit, detyrimi vjetor referues i taksës së truallit për familjet llogaritet për një sipërfaqe prej 100 m².

Për biznesin detyrimi llogaritet nga Drejtoria e të Ardhurave , dhe shlyhet pranë çdo banke dhe cdo zyrë taksash pranë Bashkisë, brenda datës 30 Qershor të vitit fiskal. Per ata subjekte qe nuk jane regjistruar pagesa e takses se truallit behet ne moment e nxjerrjes se fatures se detyrimeve qe i takojne biznesit.
Deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë ose vetëdeklarimit të sipërfaqes së truallit, detyrimi vjetor referues i sipërfaqes së truallit për bizneset llogaritet në bazë të sipërfaqes së ndërtesës së aktivitetit.

CamScanner

A.2.2 TAKSA E FJETJES NË HOTEL

Përkufizimi: Strukturat akomoduese do të përfshijnë kategoritë si më poshtë:
a)"Bujtinë";
b)"Fjetinë" (Hostel);
c)"Kamping";
ç)"Hotel";
d)"Motel";
dh)"Resort";
e)"Qendër kurative";
ë)"Fjetje dhe mëngjes" (B&B).
Secila kategori e strukturave akomoduese klasifikohet me sistem të veçantë, e shoqëruar me shenjat dalluese përkatëse, sipas përcaktimit të mëposhtëm: "Bujtinë" Standard, "Fjetinë Standard, Komfort; "Kamping" Standard, "Hotel" dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; "Motel" Standard, Komfort, Superior; "Resort" tre yje, katër yje, pesë yje; "Qendër kurative" dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; "Fjetje dhe mëngjes" (B&B) Standard, Komfort, Superior.

Baza e taksës: Është numri i netëve të qëndruara në hotel për person.
Niveli i taksës se fjetjes në hotel paraqitet si më poshtë:

Kjo takse bazohet ne Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar me Ligjin Nr. 142/2015, date 17.12.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.252, date 22.01.2016)

Tabela 5. Nivelet e taksës së fjetjes në hotel

Emërtimi	Nivelet e taksës
a. Hotelet 4-5 yje	105 lekë/natë/fjetje/person
a. Hotel nën 4yje,bujtinë,fjetinë,motel dhe çdo njësi tjetër akomodues pavaresisht emertimit qe mban, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin,	35 lekë/natë/fjetje/person

Detyrimi dhe kështet e pagimit: Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natëqëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.
Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e sëcilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.

CamScanner

Detyrimi derdhet për bashkinë brenda datës 5 të muajit pasardhës nga subjekti përkatës. Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Drejtoria e Të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.

Kjo takse bazohet ne Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", në aneksin nr. 7.

A.2.3 TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURE

Baza ligjore: Ligji Nr. 9632, Datë 30.12.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", Neni 27.
Ligji 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, Ligji Nr. 8402, Datë 10/09/1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 1, Datë 10/09/2025 të Këshillit të Ministrave "*PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË NDËRTIMIT TË BANESAVE NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE*", PËR VITIN 2025.
Struktura e ngarkuar për arkëtimin e taksës së Ndikimit në Infrastrukture: Drejtoria e Politikave Urbane dhe Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik pranë Bashkisë Rrogozhinë.

- Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.
- Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 (katër) për qind të çmimit të shitjes për metër katror.

Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, te kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncensionare, e cila banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit.
Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njësive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerrë me akt nga Këshilli i Ministrave.

- **Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara më sipër, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është:**

a. Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë,; të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara vetë individi apo me sipërmarrës; si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastructure është 1 (një) deri në 3 (tre) për qind e vlerës së investimit.
b. Për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto

CamScanner

projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0.1 (zero pikë një) për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

c. Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0.5 (zero pikë pesë) për qind e vlerës së investimit.

d. Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit.E ardhura nga taksa,mblidhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet,për llogari të bashkisë,që mbulon territorin ku do bëhet investimit.

e. Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.

- **Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse:**

a. Investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "*brand name*".

b. Investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.

c. Investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore,sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet,rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës ndikimit në infrastrukturë,sipas kësaj pikë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave

ç. investimet në kuadër të programeve të rindërtimit, sipas dispozitave të ligjit, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

Tabela.6. Nivelet taksës së ndikimit në infrastrukturë

Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Niveli i Taksës në %
a. Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi (apartamente) apo për njësi tregtimi dhe sherbimi, të cilat kryhen nga shoqeri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 (katër) % (përqind) të çmimit të shtijes për m^2. Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për tu ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese. Në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qëndra tregtare apo biznesi. Baza e taksës është vlera në lekë për m^2 e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njësive të tregtimit apo shërbimit. Çmimi i shitjes për m^2 bazohet në vlerën referuese të tregut, sipas përcaktimeve të nxjerrë me akt nga Këshilli i Ministrave.	4 (katër) % (përqind)

CamScanner

a/1. Për ndërtimin e strukturave që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dhe blegtoral dhe për objektet sportive sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sportin, taksa e ndikimit nëinfrastrukturë është jo më shumë se 1 (një) për qind e vlerës së investimit, ndërsa për Bashkinë eTiranës është jo më shumë se 2 (dy) për qind e saj."	1(një)% (përqind)
b. Për ndërtimet që destinohen për përdorim në sektorin e: turizmit, industrisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo sipërmarrës dhe shoqëri ndërtimi, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike.	3 (tre) % (përqind)
c. Për ndërtimet individuale për qëllime banimi të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individët apo me sipërmarrës dhe shoqëri ndërtimi.	2 (dy) % (përqind)
d. Për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe paisjet, kanale ujitje/kullimi,ujsjelles-kanalizime,telefoni, inernet	0.1 (zero pikë një) % (përqind) të vlerës së investimit
e. Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi	0.5 (zero pikë pesë) % (përqind) e vlerës së investimit

SHËNIM: Nëse Vlera për m^2 e preventivit të projektit të objektit të paraqitur nga investitori pranë DPU-së është më e madhe se vlera 32105 lekë/m^2 e Ilogaritur nga EKB-ve, atëherë për Ilogaritjen e tarifës që do të paguhet pranë Bashkisë Rrogozhinë do të merret për bazë ajo e preventivit të sjellë nga vetë invstitori.

A.2.4. TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2%. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Niveli i taksës: Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Tabelë 7. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Kategoritë e ndërtesave	**Njësia**	**Niveli I taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme**	
		Per njesine Rrogozhinë	**Per te gjitha njesite e tjera**

Ndërtesa banimi	Lekë/m²	100	100
Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	Lekë/m²	300	300
Ndërtesa të tjera	Lekë/m²	200	200

Detyrimi për pagesën: Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Mënyra e mbledhjes: Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila në rolin e agjentit të taksës përfiton 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdh për llogaritë buxhetit përkatës të bashkisë Rrogozhinë, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik të bëjë rakordimet dhe planifikimin e të ardhurave me ZRPP.

Kjo taksë bazohet ne Ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

A.2.5 .TAKSA E TABELËS

Baza e taksës: Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike të lejuara ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime identifikimi.
Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulantëve. Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit harton planin për vendosjen e mundshme të tabelave për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike.

Tabelë 8. Taksa e tabelës

Nr.	LLOJI I TABELAVE	Nj/Matëse	Niveliitaksës
I	Taksë tabele për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emir dhe/ose aktiviteti I biznesit)		
A	deri ne 2 m²	lekë /m² /vit	0
B	mbi 2 m² deri 10 m²		
	e thjeshtë pa ndricim	lekë /m² /vit	7 000
	me ndricim të thjeshtë	lekë /m² /vit	11 500

CamScanner

	elektronike	lekë /m² /vit	15 000
C	mbi 10 m ² deri 20 m²		
	e thjeshtë pa ndricim	lekë /m² /vit	5 950
	me ndricim të thjeshtë	lekë /m² /vit	9 775
	elektronike	lekë /m² /vit	12 750
Ç	20 m² deri 40 m ²	lekë /m² /vit	
	e thjeshtë pa ndricim	lekë /m² /vit	3 850
	me ndricim të thjeshtë	lekë /m² /vit	6 325
	elektronike	lekë /m² /vit	8 250
D	mbi 40 m ²		
	e thjeshtë pa ndricim	lekë /m² /vit	2 800
	me ndricim të thjeshtë	lekë /m² /vit	4 600
	elektronike	lekë /m² /vit	6 000
II	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim		
	Tabela identifikuese	lekë /m² /vit	120
III	Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m²		
	Thjeshtë me/pa ndriçim	lekë /m² /vit	13 500
	elektronike	lekë /m² /vit	27 000
IV	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj		
	Të të gjitha llojeve dhe përmasave	lekë /m² /ditë	1 000

Detyrimi dhe kështet e pagesës: Detyrimi për Taksën e Tabelës për Kategorinë 1 dhe 2 është vjetor.

- Për "kategorinë 1" për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës 30 Qershor të vitit fiskal. Për subjektet që duan të identifikohen me tabelë të re pas datës 30 Qershor, detyrimi llogaritet dhe paguhet Brenda 30 diteve për periudhën nga deklarimi.

CamScanner

- Në rastin e më shumë se një tabele, pavarësisht nga vendndodhja, vetëm njëra do të konsiderohet si tabelë me qëllime identifikuese, ndërsa tabelat e tjera do të konsiderohen si tabela me qëllime reklamuese.
Për "kategorinë 2" për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës 30 Qershor të vitit fiskal. Për subjektet e reja detyrimi llogaritet dhe paguhet menjehere sipas periudhës së përcaktuar në kontratën e nënshkruar me strukturat përkatëse të Bashkisë .
- Për "kategorinë 3" detyrimi llogaritet sipas ditëve të përcaktuara në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatëse të Bashkisë Rrogozhinë dhe paguhet menjëherë.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:
Për Kategoritë 1, 2, 3 dhe 4 : Drejtoria e Shërbimit Publik ngarkohet për shqyrtimin e kërkesës nga ana e subjektit, si dhe për hartimin e dokumentacionit të plotë të marrjes së lejes për vendosjen e reklamave dhe përcaktimin e sipërfaqeve objekt taksimi. Kjo Drejtori njofton çdo fillim viti Drejtorinë e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik në lidhje me të gjitha ndryshimet në sipërfaqe (shtesa apo pakësime) që janë objekt i kësaj takse.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës:
Struktura e ngarkuar për arkëtimin e taksës së tabelës për të gjitha kategoritë 1,2,3,4 është Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik. Arkëtimi do të bëhet mbështetur në dokumentacionin e miratuar nga Drejtoria e Shërbimeve dhe që i është dorëzuar Drejtorisë së të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
Inspektorët e Kontrollit pranë Drejtorisë së të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik në mbështjetje të Policisë Bashkiake do të bëjnë kontrollin e zbatimit të vënies së tabelave sipas lejes së dhënë nga Drejtoria e Shërbimeve.

- Për kategorinë 3 "Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme deri në tavanin maksimal 35m^2 " do të përfshihen edhe reklamat qëpërbëhen nga shkronja të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si: mur, fasadë e jashtme e çdo lloji, shtyllë, kolonë, apo të ngjashme me to të cilat vendosen mbi një sipërfaqe ekzistuese.

Kategoritë e bazës së taksës së tabelës dhe niveli i tyre jepen në ankesin nr.7, të ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar

A.2.6. TAKSA E MJETEVE TË PËRDORURA

Baza e taksës: Është lloji i mjetit të transportit rrugor.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e mbledhjes së kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore, njëzet e pesë përqind (25%) të të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Rrogozhinë në llogarinë e degës së thesarit.

CamScanner

Kjo takse bazohet në Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare" i ndryshuar.

A.2.7. TË ARDHURA PJESORE NGA TAKSA E RENTËS MINERARE

Baza e taksës: Janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Çdo person fizik apo juridik, që është i liçencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, (5%) e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Rrogozhinë ne llogarinë e degës së thesarit. Pagesa e rentës minerare bëhet brenda datës 15 të muajit pasardhës, kur janë realizuar shitjet.

Kjo taksë bazohet në Ligjin Nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare" i ndryshuar.

TARIFAT VENDORE

Ky kapitull trajton tarifat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:
- Llojit të shërbimit, nivelit te tarifes bazuar ne koston e sherbimit, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Tarifat që aplikon Bashkia Rrogozhinë bazohen në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e tasave vendore" nenit 35 si edhe në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

A.3.1 TARIFË PËR INFRASTRUKTURËN NËNTOKËSORE (TELEFON, INTERNET, KABLLOR)

Për rrjetet kabllore telefonike, ndërlidhëse apo të shërbimit informatik, tarifat vendore vendosen vetëm në rastin kur subjektet përdorin rrjetet infrastrukturore, si : tubacione, kanale etj., të cilat janë ndërtuar dhe janë në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore. Të ardhurat e siguruara prej tyre shërbejnë për përballimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e rrjetit në përdorim .

Tabela nr. 9 Tarifa për linjat nëntokësore (telefoni, energji, tv kabllor, internet)

		Njësi	Vlerë
1	Për linjat nëntokësore	Lekë/km/vit	3 000 lekë
2	Linjat Ajrore	Lekë/km/vit	1 500 lekë

CamScanner

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifës: Struktura e ngarkuar për llogaritjen e pagesës së tarifës për linjat nëntokësore është Drejtoria e Politikave Urbane.

A.3.2 TARIFA E PASTRIMIT DHE LARGIMIT TË MBETURINAVE SI DHE TARIFA E GJELBËRIMIT DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

Përkufizimi: Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë D dhe njësive të saj administrative.

Subjekte te tarifes se ndricimit jane familjaret e regjistruar me banim ne Bashkinë Rrogozhinë, ashtu edhe personat fizike ose juridike, vendas ose te huaj, qe ushtrojne veprimtari ekonomike brenda territorit te Bashkise së Rrogozhinës

Tarifa e gjelbërimit është detyrueshme për të gjithë personat fizike ose juridike, vendas ose te huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Rrogozhinë.
Tarifa e gjelbërimit është e detyrueshme dhe e aplikueshme për pagesë për çdo familje të regjistruar me banim në qytetin e Rrogozhinës.
Të gjithë subjektet që veprojnë si nënkontraktues në fushën e ndërtimit, do të paguajnë tarifën e ndriçimit rregullisht sipas ligjeve tatimore në fuqi.

Tabela nr. 10 Tarifa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndricimit për kategorine "Familje"

		Lloji i tarifës	
III 1. Sipas Njesisë Administrative	**Nr. familjeve**	**Tarifë Pastrimi Lekë/Vit**	**Tarifë Shërbimi (Gj+Nd+Ndryshme)**
1-Nj.A. Rrogozhinë	3813	1200	800
2-Nj.A. Gosë **Zona A**. G. Qëndër G.Vogël, Kërcukaj,Vilë, Ballaj. **Zona B**. Kalush, Gosë e madhe.	2488	1200 600	800 800
3-Nj.A. Lekaj **Zona A**.Lekaj,Luz,Shkozet,Hariz,Kryeluz, Gërmenj **Zona B**. Zambisht, Okshtun. **Zona C**. Mushnik, Mlik.	2481	1200 600 0	800 300 0
4-Nj.A. Kryevidh. **Zona A**. Kryevidh, Greth i Mesëm, Spille, Ballaj, Zhabjak. **Zona B**. Sharrdushk, Greth M **Zona C**.Kazie,Domen,Spanesh,Patk Milot, Sterbeg	2542	1200 600 0	800 800 0

CamScanner

5-Nj.A. Sinaballaj Zona B. Sinaballaj Qëndër Zona C. Fshatra të tjerë	527	600 0	800 0

Tabela 11. Tarifa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit për kategorinë Biznes i Vogël

Emërtimi	Lekë Vit Sez.	Tarifë Pastrimi	Tarifë Gjelbërimi	Tarifë Ndriçimi
1. Shitje me Pakicë				
a. Bar Kafe		15.000	1.000	1.000
b. Bar Bufe ,Restorant, fast food e të ngjashme me to		20.000	1.000	1.000
c. Restorante (Dasma, etj).		30.000	1.000	1.000
d. Ushqimore, minimarket, fruta perime, bulmet, mish, peshk, etj.		20.000	1.000	1.000
e. Beach Bar.		30.000	1.000	1.000
f. Tregtim pjesë këmbimi e servis mekanik.		20.000	1.000	1.000
g. Tregtim materiale ndërtimi si tulla, tjengulla, dërrasa, çimento, gëlqere, blloqe betoni etj.		20.000	1.000	1.000
h. Tregtim lënde djegëse si dru, qymyr, pelet etj.		15.000	1.000	1.000
i. Tregtim plehra kimike, pesticide, fara e fidan.		20.000	1.000	1.000
j. Tregtim artikuj industrial (veshje, parfumeri, argjendari etj)		15.000	1.000	1.000
2. Prodhime si më poshtë:				
a) Prodhime material druri e duralumini.		30.000	1.000	1.000
b) Prodhim e shitje buke e n/produkte të saj, byrektore etj		15.000	1.000	1.000
c) Grumbullim përpunim qumështi e n/produkte.		20.000	1.000	1.000
d) Prodhim vaj ulliri.	Sez	20.000	1.000	1.000
3. Profesione të lira				
a. Farmaci të të gjitha llojeve.	vit	20.000	1.000	1.000
b. Klinika dentare, laborator, qëndër mjeksore.		20.000	1.000	1.000
c. Profesione të lira Këpucar, fotograf, rrobaqepës,berber etj..		12.000	1.000	1.000
d. Ndërtues, murator etj.		20.000	1.000	1.000
e. Hotele, motele, shtëpia që shërbejnë për akomodimin e turistëve e të ngjashme (vija bregdetare).	Sez	50.000 +500 lekë/dhomë	2.500	2.500
f. Hotele, motele e të ngjashme në zonat e tjera.		30.000	1.000	1.000
g. Tregtim mjete të reja.		30.000	1.000	1.000
h. Kënd lojrash, lodra uji.	Sez	20.000	1.000	1.000
i. Autoshkollë,Agjensi Udhëtimi, Internet, Telefon.		15.000	1.000	1.000
j. Peshkimi në ujra të ëmbla e të kripura, kultivim kerminjsh etj		20.000	1.000	1.000

CamScanner

k. Kalceto (fusha sportive për të rritur e fëmijë).		15.000	1.000	1.000
l. Shitje online		10.000	1.000	1.000

Tabela 12. Tarifa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit për kategorinë Biznes i Madh

Tarifat e Biznesit të Madh	**Njesia**	**Tarifë Pastrimi**	**Tarifë Gjelbërimi**	**Tarifë Ndriçimi**
1. Njësi tregtare dhe Shërbime				
a. Ushqimore Supermarketi	leke|/vit	60.000	2.500	5.000
b. Bar, restorant, fast-food, etj	leke|/vit	50.000	2.500	5.000
c. Njësi tregtimi vetëm me shumicë	leke|/vit	50.000	2.500	5.000
d. Import-Eksport pjesë këmbimi auto, shitje automjetesh	leke|/vit	50.000	2.500	5.000
e. Tregtim materiale ndërtimi, mobilje	leke|/vit	50.000	2.500	5.000
f. Tregtim lënde djegëse karburante	leke|/vit	50.000	2.500	5.000
g. Tregtim plehra kimike, inpute bujqësore etj	leke|/vit	40.000	2.500	5.000
h. Tregtim paisje industriale prodhuese e makineri	leke|/vit	60.000	2.500	5.000
2. Prodhime				
a. Prodhime mielli e nënprodukte, qumështi e nënprodukte	leke|/vit	50.000	2.500	5.000
b. Prodhim për përpunim mishi e nënprodukte të tij	leke|/vit	50.000	2.500	5.000
c. Prodhim materiale ndërtimi e inerte, materiale plastike	leke|/vit	60.000	2.500	5.000
d. Prodhim kanfeksione, veshmbathje, dyshek, jorgane etj	leke|/vit	50.000	2.500	5.000
e. Prodhim të produkteve të drurit, duraluminit të ngjashme	leke|/vit	50.000	2.500	5.000
3. Shërbimet				
a. Banka private apo filiale të tyre, të ngjashme me to	leke|/vit	50.000	2.500	5.000
b. Kompani, Agjensi sigurimesh, Këmbim valutor	leke|/vit	40.000	2.500	5.000
c. Media televizive, Kabllor e të ngjashme me to.	leke|/vit	50.000	2.500	5.000
d. Shërbime postare, kompani telekomunacioni, shërbime interneti, telefoni fikse e të ngjashme me to.	leke|/vit	50.000	2.500	5.000
e. Për çdo autoshkollë, polici private, kurse kualifikimi etj	leke|/vit	50.000	2.500	5.000
f. Për cdo njësi edukimi si shkolla, kopshte, klub sportiv,etj	leke|/vit	40.000	2.500	5.000
g. Ndërrmarje, shërbim Energjie Elekrtike, UK.	leke|/vit	50.000	2.500	5.000
h. Lojëra fati, lloto sport, baste sportive, etj	leke|/vit	40.000	2.500	5.000
4. Për çdo agjensi transporti me Nipt parësor apo sekondar sipas Q.K.B	leke|/vit	50.000	2.500	5.000
a. Transport Udhëtarësh deri në 8+1	leke|/vit	5.000	1.000	1.000

CamScanner

b. Mbi 8+1	leke/vit	15.000	1.000	1.000
c. Transport mallrash deri në 3.5 ton	leke/vit	5.000	1.000	1.000
d. Mbi 3.5 ton	leke/vit	15.000	1.000	1.000
e. Për cdo motobarkë peshkimi	leke/vit	10.000	1.000	1.000
f. Për cdo barkë me motorr apo pedalon në shërbim të pushuesve në stacione plazhi Spille		5000		
5. Subjektet që përfitojnë tendera shërbimesh e punimesh brenda territorit të bashkisë	vjetore	100.000	10.000	10.000

Tabela 13. Tarifa e pastrimit për Subjektet e ndërtimit

	Tarifa e Pastrimit për Subjektet e Ndertimit			**Banim**	**Biznes**
	Për çdo leje ndërtimi / rikonstruksione në objekte ekzistues , shtesë kati me siperfaqe ndërtimi deri në 250m2			10.000 leje/ndërtimi	20.000 leje/ndërtimi
	Për çdo leje ndërtimi / rikonstruksione në objekte ekzistues , shtesë kati me siperfaqe ndërtimi mbi 250m2 deri në 4-kt .			20.000 leje/ ndërtimi	40.000 leje/ndërtimi
	Për çdo leje ndërtimi / rikonstruksione për objekte mbi 4-kt			150.000 leje/ndërtimi	150.000 leje/ndërtimi

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit është Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit ekonomik, pranë Bashkisë Rrogozhinë.

Baza e tarifës: është vlera në lekë sipas kategorive e cila duhet të mbulojë koston e shërbimit. Detyrimi për pagesën: Detyrimi për Tarifën e pastrimit është vjetor.

Kategoria "Familjarët": Detyrimi paguhet është vjetorë dhe paguhet për çdo familje. Për çdo familje të re, afati i pagesës së tarifës se pastrimit do të jetë 30 ditë nga dita e regjistrimit të saj në Zyrën e Gjëndjes Civile përkatëse dhe detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i rregjistrimit të saj. Detyrimi paguhet brenda datë 30 Qershor.

Kategoria "Biznes". Detyrimi paguhet brenda datës 30 Qershor. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 Qershor është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKB.

CamScanner

Kategoria "Subjekte Ndërtimi" Për "Subjektet e ndërtimit sipas investimit, dhe kohëzgjatjes së kantierit të ndërtimit", llogaritja e tarifës bëhet për periudhën nga momenti i ngritjes së kantierit të ndërtimit deri në momentin e dorëzimit nga subjekti pranë strukturave të Bashkisë Rrogozhinë të kërkesës për leje shfrytëzimi. Të gjitha subjektet ndërtuese do të tërheqin lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Rrogozhinë vetëm pasi të kenë paguar detyrimet përkatëse për selinë administrative dhe për "çdo kantier ndërtimi", para zbardhjes së lejes së ndërtimit si dhe pasi të kenë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë. Këtu përjashtohen kantieret e ndërtimit që përbëjnë vepra publike dhe financohen nga buxheti i Bashkisë apo buxheti i shtetit.

a) *Përjashtohen nga tarifa vendore* , fermerët që janë regjistruar me NIPT sipas vërtetimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore sipas udhëzimit Nr. 19, datë 3.11.2014, "Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar" përjashtohen nga tarifa vendore për biznesin.

b) *Përjashtohen nga tarifa vendore*: Institucionet, subjektet dhe organizatat në pronësi të bashkisë; Institucionet dhe subjektet e varësisë së Bashkisë Rrogozhinë ; Institucionet që shpenzimet operative ia mbulon vetë Bashkia Rrogozhinnë ; Komunitetet fetare të njohura me ligj.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifës : Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së pastrimit, gjebërimit dhe ndriçimit është Drejtoria e AZHE.

Struktura e ngarkuar per vjeljen e Tarifes së Pastrimit për kategorinë "Subjekte Ndërtimi"është Drejtoria e Politikave Urbane.

A.3.3 Tarifat e urbanistikës.

Tarifat e aplikueshme nga Bashkia për këtë kategori, janë si më poshtë vijon:

- **Sipas Relacionit të dërguar nga Drejtoria e Politikave Urbane Tarifat për vitin 2026 të për shërbime të ndryshme ndaj qytetarëve dhe firmave të ndërtimit janë:**
  a.Tarifë Aplikimi (Hapje Dosje).....2.000 lekë.
  b.Tarifa për punimet që kryhen me deklaratë paraprake punimesh të jetë 2% i vlerës së preventivit kur destinohen per qellime banimi.
  c.Tarifa për punimet që kryhen me deklaratë paraprake punimesh të jetë 3% i vlerës së preventivit kur destinohen per qellime biznesi .
  d. Tarife per procedure te pershpejtuar ne systemin e-leje..... 20.000 leke

  e.Tarife per ndryshim funksioni nga njesi sherbimi ne banim ..... 2% e preventivit

  f.Tarife per ndryshim funksioni nga banim ne njesi sherbimi ..... 3% e preventivit

CamScanner

- Tarifat për Akt-Kontrollet në faza të ndryshme të ndërtimit të objekteve të ushtruara nga personeli i Drejtorisë së Politikave Urbane.

Në bazë të VKM Nr. 408, Datë 13.05.2015 të "*Rregullores se Zhvillimit te Territorit*", Nenit 27/1 për Mbikqyrjen e Punimeve, mbahen këto Akte Kontrolli kundrejt pagesave të mëposhtme:

Tabela 14. Niveleta e tarifave për Akt-Kontrolle të punimeve të ndryshme

Nr.	Lloji Punimeve	Lloji Ndërtesës	Tarifa
a.	Ngritje kantier + Mur Rrethues	Për Banesë Për Biznes Pallat + Bregdet	10 lekë/m²(Të sip. Totale të ndërtimit) 20 lekë/m²(.....) 25 lekë/m²(.....)
b.	Piketim Objekti	Për Banesë Për Biznes Pallat + Bregdet	10 lekë/m²(Të sip. Totale të ndërtimit) 20 lekë/m²(.....) 25 lekë/m²(.....)
c.	Përfundim i themeleve Kuota 0.00	Për Banesë Për Biznes Pallat + Bregdet	10 lekë/m²(Të sip. Totale të ndërtimit) 15 lekë/m²(.....) 25 lekë/m²(.....)
ç.	Përfundimi i karabinasë	Për Banesë Për Biznes Pallat + Bregdet	10 lekë/m²(Të sip. Totale të ndërtimit) 15 lekë/m²(.....) 25 lekë/m²(.....)
d.	Përfundimi i fasadave dhe rifinaturave + sistemet e ndryshme si ngrohje, ftohje, elektrike, hidraulike etj	Për Banesë Për Biznes Pallat + Bregdet	5 lekë/m²(Të sip. Totale të ndërtimit) 15 lekë/m²(.....) 25 lekë/m²(.....)
e.	Përfundimi i sistemeve të jashtme	Për Banesë Për Biznes Pallat + Bregdet	5 lekë/m²(Të sip. Totale të ndërtimit) 15 lekë/m²(.....) 25 lekë/m²(.....)

Në total, të gjitha Akt-Kontrollet bëhen këto pagesa:

a. Për Banesë 50 lekë/m² (të sip. totale ndërtimi)

b. Për Biznes 100 lekë/m² (të sip. totale ndërtimi)

c. Për Pallate dhe Bregdet 150 lekë/m² (të sip. totale ndërtimi)

SHËNIM: Për Objektet që janë pajisur me "Leje Zhvillimi" dhe "Leje Ndërtimi" para këtij vendimi, tarifa e Akt-Kontrolleve do të paguhet me vlerat e mëparshme.

- **Tarifat për marrjen e Çertifikatës së Përdorimit të Objekteve:**

a. Çertifikatë Përdorimi për Banesë 100 lekë/m² (të sip. totale ndërtimi)

b. Çertifikatë Përdorimi për Biznes 150 lekë/m² (të sip. totale ndërtimi)

c. Çertifikatë Përdorimi për Pallate 250 lekë/m² (të sip. totale ndërtimi)

d. Çertifikatë Përdorimi për Zonën Turistike 250 lekë/m² (të sip. totale ndërtimi)

CamScanner

Struktura e ngarkuar per leshimin e autorizimit dhe vjeljen e pageses per tarifat e urbanistikes eshte Drejtoria e Politikave Urbane, Bashkia Rogozhinë.

A.3.4 TARIFË E ZËNIES SË HAPËSIRËS PUBLIKE PËR ZONËN E PLAZHIT

A 3.4.1 Tarifa për zënien e sipërfaqeve të hapësirës publike

Tarifa për zënien e hapësirës publike llogaritet si detyrim mujor i tatimpaguesit. Këshilli bashkiak vendos për nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e kësaj tarife si dhe mund të caktojë nivele te ndryshme të kësaj tarife, sipas nivelit të zhvillimit të veprimtarisë së biznesit në zona të ndryshme të qëndrës së banuar. Tarifa për zënien e hapësirës publike nuk zbatohet për hapësirat që nuk janë në pronësi dhe nën administrimin e pushtetit vendor.
Kategorite dhe nenkategorite e Tarifës per zenien e hapesirave publike, jane si vijon:

Tabela 15. Tarifa e zënies së hapësirës publike

	KATEGORIA DHE NENKATEGORITE	NJËSIA
1	*Qyteti Rrogozhinë* 1-Vendosje tavolinash jashtë objektit të aktivitetit: a-Zona A. Brenda Qëndrës së Qytetit (Zonë pedonale)	60 lekë/m2/muaj
1.1	Zona B. Jashtë Qëndrës së Qytetit (Periferi)	60 lekë/m2/muaj
1.2	Vendosje tavolina në pisha Spille	100lek/m2/sezon
2.	Mallra jashtë zonës së tregtimit .Objekte të përkohshme me qëllim ushtrim aktiviteti tregtar, (Tezga, Rulote, Kënde lojrash, Ambulant statik ose i levizeshem), sipërfaqet e zëna me platforma te perkoheshme, (Me materjal te lehta ta cmontueshem qe nuk demtojne siperfaqen ekzistuese), sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bimë dekorative, me kangjella, drurë dekorativë, kufizime me plastmase e të tjera, të ngjashme me to.	60 lekë/m2/muaj
3	Aktivitet në qendër të qytetit, veprimtari promocionale të ndryshme	1000 lekë/m2/ditë
4	Aktivitet në Qendrën kulturore në qendër të qytetit	2500 lekë/orë
5	Aktivitet në pika turistike Kalaja Bashtovës e të ngjashme	3000 lekë/orë
	Tarifat për ngritjen e kampingjeve e objekteve të lëvizshme në Spille	
1	Vendosje çadra pushimi deri në 4 vende	100 lekë/ditë/copë
2	Vendosje çadra pushimi mbi 4 vende	200 lekë/ditë/copë
3	Vendosje Rulota (jo më pak se 25.000 lekë/sezon)	300 lekë/ditë/copë
4	Vendosje Baraka portative (jo më pak se 25.000 lekë/sezon	300 lekë/ditë/copë
5	Shitës ambulante (jo më pak se 15.000 lekë/sezon)	100 lekë/ditë/m2

Për vijën bregdetare në zonën e Vil-Bashtovës niveli i tarifës do të jetë 60% e Spillesë.

CamScanner

Struktura përgjegjëse për dhenien e lejes për Hapësirën Publike është Drejtoria e Shërbimeve Publike, pranë Bashkisë Rrogozhinë

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës është Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik pranë Bashkisë Rrogozhinë.

Kjo taksë bazohet në aneksin nr, 6 të Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

A.3.4.2 Tarifa e plazheve private

Kjo tarife aplikohet mbi te gjithe subjektet te cilat shfrytezojne siperfaqen e reres pergjate vijes bregdetare miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 649, datë 16.10.2024 Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit".
Baza e tarifes eshte siperfaqja e reres ne m^2.

Tabela 16. Tarifa e plazheve private

QYTETI/NJËSIA ADMINISTRATIVE	Niveli lek/m^2/sezon turistik
Spille	250 lek/m^2/sezon turistik
Vil-Bashtovë	150 lek/m^2/sezon turistik

Kërkesa për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi dhe të strukturës së shërbimit, sipas rastit, bëhet direkt nga subjekti i interesuar nëpërmjet portalit *e-Albania*, sipas njoftimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Në rast se subjekti i plotëson kriteret sipas Vendimit nr. 649 datë 16.10.2024 "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" dhe dokumentacioni i paraqitur rezulton i plotë, Grupi Teknik i Shqyrtimit të aplikimeve GTSHA-ja njofton subjektin nëpërmjet portalit *e-Albania* dhe njofton elektronikisht Agjencinë Kombëtare të Bregdetit ("AKB") dhe njësinë përkatëse të vetëqeverisjes vendore (në vijim "NJVV"), me qëllim plotësimin e dokumentacionit shtesë. NJVV-ja është përgjegjëse për mbledhjen e detyrimeve të tarifës për çdo vit (referuar Nenit 6, pikës 2 të VKM-së). Përpara fillimit të sezonit turistik të vitit pasardhës, NJVV-ja njofton zyrtarisht AKB-në për statusin e detyrimeve nga ana e subjekteve me të cilat është lidhur kontrata.

Struktura e ngarkuar per ndjekjen e procedurave me AKB – në është Drejtoria e Politikave Urbane, pranë Bashkisë Rrogozhinë.

CamScanner

Struktura e ngarkuar për arkëtimin e kesaj tarife eshte Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.

A.3.4.3 Tarifa per siperfaqe te tregut ne administrim te Bashkisë Rrogozhinë.

Tarifa për sipërfaqen e ambjenteve në tregje i nënshtrohen të gjitha subjektet të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në këto tregje, të cilët janë nën administrim të Bashkisë Rrogozhinë.
Baza e taksës së përkoshme të tregut është sipërfaqja në m^2, e cila vihet në shfrytëzim për tregtimin e artikujve të ndryshëm brenda terrotirit të tregut. Taksa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit. Kategoritë dhe nivelet e kësaj takse janë si më poshtë:

Tabela 17. Tarifa për sipërfaqen e ambjenteve në tregje (propozojm heqjen e tarifave)

NR	Kategorite	Njesia lek/m2 ne ditë
1	Fruta perime	50
2	Bylmet mish peshk	50
3	Artikuj industrial	50

A.3.5 TARIFA E LIÇENSIMIT TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE DHE MALLRAVE

Baza Ligjore Ligji Nr. 8303, datë 18.03.1998 "*Për Transportet Rrugore*" i ndryshuar

Struktura e ngarkuar per leshimin e autorizimit dhe vjeljen e pageses per kete tarife eshte Drejtoria Sherbimeve, prane Bashkisë Rrogozhinë.

Tabela 18. Tarifat e Licensimit të Transportit të udhëtarëve dhe mallrave.

Nr.	Kategoritë	Njësia matjes	Tarifa e licensimit të transportit
1	Licensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	Lekë/5 vjet	40.000
2	Certifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	Lekë/mjetë/vit	1.000
3	Licensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	Lekë/5 vjet	20.000
4	Certifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	Lekë/mjetë/vit	1.500
5	Licensë për agjensi transport udhëtarësh dhe taksi Brenda	Lekë/5 vjet	15.000
6	Licensë për transport udhëtarësh me taksi	Lekë/mjet/5vjet	20.000
7	Licensë për shërbim të rregullt të specializuar të transportit të udhëtarëve	Lekë/5 vjet	20.000
8	Certifikatë për transport udhëtarësh për llogari të vet	Lekë/mjetë/vit	1.500
B	Tarifa Licensimit të Transportit të Mallrave		

CamScanner

1	Licensë për transport mallrash për të trete dhe me qera brenda vëndit	Lekë/5 vjet	40.000
2	Certifikatë për transport mallrash për të tretë e për vete brenda vëndit	Lekë/Ton/vit	100
3	Certifikatë për transport mallrash dhe udhëtarë	Lekë	3.000

A.3.6 TARIFA E PARKIMIT TE AUTOMJETEVE

Baza ligjore: Ligji Nr. 8652, Datë 31.7.2000 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore*", i ndryshuar.

- Tarifa parkimit e të automjeteve është detyrim i çdo individi i cili parkon në vendet e miratuara si "Parkim publik me Pagesë".
- Tarifa është 100/lekë/automjet/ditë dhe arkëtohet në momentin e parkimit.
- Tarifa është 200/lekë/automjet/ditë për zonën e Spille dhe arkëtohet në momentin e parkimit

Tabela 19. Parkime të Rezervuara me Leje nga Bashkia për qytetin Rrogozhinë

a) Autoveturë 4+1 dhe 8+1	Niveli tarifes 15.000lekë/vit
b) Automjet Transporti të perzier nga 0-3.5 ton	Niveli tarifes 15.000lekë/vit

Shënim. Subjektet e biznesit të vogël mund të marrin leje vetëm për 3-4 vende parkimi, ndërsa subjektet e biznesit të madh jo më shumë se 5 vende parkime.
Leja nuk mund të jepet për një periudhë kohe jo më pak se 1 vit.
Struktura e ngarkuar për arkëtimin e tarifes së Parkimit të Automjeteve: Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik pranë Bashkisë Rrogozhinë dhe zyrat e Taksave dhe Tarifave prane Nj. Administrative përkatëse

A.3.7 TARIFA BAZË TË LËNDËS DRUSORE NË KËMBË, PËR LLOJET INDUSTRIALE

Baza Ligjore: Vkm Nr. 559, Datë 29.07.2022 "*Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim, përdorim të fondit Pyjor Kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhim drysor dhe jo drysor*"
Struktura e ngarkuar për Arkëtimin e kësaj tarife: Drejtoria e Bujqësisë

Tabela 20 Tarifa për Lëndë drusore për llojet industriale

	Njësia	Tarifa
1) Pishë Mesdhetare	**m^3** **m^3**	**Deri 22 cm 2300 Lekë** **Mbi 22 cm 3200 Lekë**
2) Dru Zjarri		

CamScanner

a) **Të forta:** Dushk, Ah, Panj, e të ngjashme	m	500
b) **Të buta:** Halore, shelg, e të ngjashme	m	200

Shënim: Kur lënda e punimit apo drutë e zjarrit janë nxjerrë nga sipërfaqe të djegura, por materiali drusorë është i përdorshëm, tarifa për to do të jetë 40% më e ulët se tarifa bazë.

Tabela 21 Tarifat për dhënie në përdorim të fondit pyjor për mbarështrimin e faunës së egër të gjahut

Nr.	Përdorimi territorit	Tarifat sipas kohëzgjatjes së kontratës lekë/ha/vit		
		1 vit	2-5 vjet	6-10 vjet
1.	Pyll trungishte	36000	34000	30000
2.	Pyll cungishte	24000	23000	20000
3.	Pyll shkurre	24000	23000	20000
4.	Kullota	24000	23000	20000
5. T	Tokë me bimësi pyjore	18000	17000	15000
6.	Inproduktive	18000	17000	15000

Tabela 22 Tarifat për dhënie përdorim të fondit pyjor për qëllime argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe veprimtari turistike kampingje, kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhëse.

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit		
		1 vit	2–5 vjet	6–10 vjet
1	Pyll, trungishte	198000	132825	110000
2	Pyll, cungishte	138000	99000	82500
3	Pyll, shkurre	138000	99000	82500
4	Kullotë	138000	99000	82500
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	99000	57000	49500
6	Inproduktive	99000	57000	495000

Tabela 23 Tarifat për grumbullimin dhe nxjerrjen e prodhimeve të dyta.

	Emërtimi	Njësia matjes	Tarifa/Lekë
A.	a) Gjethe të ndryshme	Kv.	150
B.	b) Rrënjë të ndryshme	Kv.	250
C.	c) Herba të ndryshme	Kv.	200
D.	d) Boçe të ndryshme	Kv.	500
E.	e) Degë të gjelbëra me dhe pa lule	Kv.	1000

A.3.8. TARIFAT PËR UJITJEN E TOKAVA BUJQËSORE

Baza ligjore: Ligji 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar Neni 9.
Struktura e ngarkuar për arkëtimin e këtyre tarifave: Drejtoria e Bujqësisë.

Tabela 24. Niveli i Tarifës për Ujitjen në tokat bujqësore

Kategori, nënkategori	Njësia	Niveli i tarifës

CamScanner

a) Me rrjedhje të lirë	Lekë/ha/rast ujitje	1000
b) Me rrjedhje mekanike	Lekë/ha/rast ujitje	0

A.3.9 TARIFA E KULTIVIMIT TË PËSHKUT NË REZERVUARE

Baza ligjore: Ligji 139/2015, Datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar

Struktura Përgjegjëse për arkëtimin e këtyre tarifave: Drejtoria e Bujqësisë.

- Për të gjithë Ujë-mbledhësit(Rezervuaret) të cilët do të shfrytëzohen për aktivitet akuakulture(rritje,kultivim,mbarështim e peshkut)tarifa vjetore do të jetë 15.000 lekë.

A.3.10 TARIFA PËR DHËNIE LICENSE PËR TREGTIMIN E NAFTËS BRUTO DHE NËNPRODUKTEVE TË SAJ

Baza ligjore: V.K.M Nr. 970, Datë 02.12.2015 "*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*"Pika II
Struktura e ngarkuar për dhënien e licensave dhe arkëtimin e tarifës për dhënien e tyre: Drejtoria e Shërbimeve Publike.

- Dhënia e licensave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga Bashkia Rrogozhinë, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territor të saj.

Tabela 25 Tarifat për dhënie licensash për tregtimin e naftës bruto e nënprodukteve saj

	Njësia	Niveli i Tarifës
a) Dhënie dhe përsëritje e licensave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante per 5 vjet.	Lekë/licensë	1 000 000
b) Dhënia e licensave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë per 5 vjet.	Lekë/licensë	100 000

CamScanner

A.3.11 KUNDRAVAJTJET DHE MASAT E GJOBAVE

Baza Ligjore: Ligji Nr. 10279, datë 20.05.2010 "*Për kundravajtjet administrative*" Neni10, Pika 3, Neni 6, Pika b.

Struktura përgjegjëse për llogaritjen dhe Arkëtimin: Ç'do drejtorie që ka detyrim ligjor për të konstatuar kundravajtjen dhe masën e gjobës në bashkëpunim me Sektorin e Policisë Bashkiake

Tabela 26 Lloji kundravajtjeve dhe masa e gjobës

Nr	Lloji i kundërvajtjes së kryer	Masa e gjobës
1	Për dëmtim, çarje dhe ndotje rruge	10 000 Lekë
2	Për dëmtim, çarje, ndotje trotuari	10.000 Lekë
3	Për dëmtim bordure	10.000 Lekë
4	Për dëmtim, rrjetit kanalizimeve,bllokim pusete	10.000 Lekë
5	Për vjedhje të zgarës	20.000 Lekë
6	Për vjedhje kapak pusete	10.000 Lekë
7	Lidhjet e pamiratuara në rrjetin ajror	20.000 Lekë
8	Dëmtimi i shtyllave	10.000 Lekë
9	Dëmtimi i ndriçuesve të qytetit	20.000 Lekë
10	Përdorimi i shtyllave si suport për reklamë	10.000 Lekë
11	Ndërhyrje në kuadrot e komandimit për ndriçimin publik	10.000 Lekë
12	Lidhjet e pamiratuara në rrjetin ajror	10.000 Lekë
13	Dëmtimi i rrjetit ajror nga punimet pa leje	10.000 Lekë
14	Lidhjet e pamiratuara në tubacionet e ujit	10.000 Lekë
15	Dëmtimi i pusetave të kanalizimit	5.000 Lekë
16	Gjoba për të gjitha kategoritë e dëmeve	10.000 Lekë
17	Gjoba për të gjitha kategoritë e dëmeve	20.000 Lekë
18	Ushtrim aktiviteti pa leje transporti:Motokarro, Autovetura, Furgon, Minibus,Mjete me tonazh të lartë	Në bazë të Ligjit Nr.8378, Datë 22.07.1998, i ndryshuar "Kodi Rrugor"
1	Mospajisje me leje veprimtarie për të gjithë subjektet që ushtrojnë	10.000 Lekë

CamScanner

9	aktivitet transporti, imbarkimin e mjeteve të transportit, shërbime në lyerje mjetesh, shërbime lavazho, parkime, gomisteri, zdruktari, etj	deri 20.000 Lekë
20	Mospajisje me leje për tregëtim gazetari,etj	5.000 Lekë
20	Mospajisje me leje për tregëtim e shërbime ambulatore, auto, dyqane dhe rulote	5.000 Lekë
21	Mospajisje me leje për ushtrim aktiviteti "24-orësh"	10.000 Lekë
22	Mospajisje me leje për zënien e hapësirave publike: Reklama të zakonshme/elektronike	5.000 Lekë deri 10.000 Lekë
23	Mospajisje me leje për mjetet që trasportojnë mbetje të ngurta në qytet dhe zonat turistike	10.000 Lekë -20.000 Lekë
24	Për vendosjen e posterave pa leje	10.000 Lekë
25	Për çdo copë posteri në pemë pa leje	5.000 Lekë
26	Për çdo dëmtim të fasadës, vendosje tabelash, pankarta pa leje	10.000 Lekë
27	Vendosje mbishkrimesh pa leje në hapësira publike	20.000 Lekë
28	Hedhje e mbeturinave jashtë vëndeve të përcaktuara nga Bashkia Persona juridikë - fizikë	10.000 Lekë
29	Lëvizja e kontenierëve të mbetjeve urbane nga vëndi i miratuar nga Bashkia: Persona juridikë - fizikë	10.000 Lekë
30	Për ndotje të hapësirës publike jashtë rrethimit të kantierit të ndërtimit nga inerte, apo material të tjera ndërtimore	10.000 Lekë
31	Mosndërtim i bazamenteve të kontenierëve të mbetjeve urbane nga subjektet e ndërtimit	20.000 Lekë
32	Për rastet kur kamionët, të cilët trasportojnë materiale ndërtimore, nuk janë mbuluar dhe që krijojnë ndotjen e hapësirave publike, gjatë transportimit	20.000 Lekë
33	Për hedhje mbeturinave ndërtimore jashtë territorit të përcaktuar për këtë qëllim nga Bashkia: Për shoqëritë e transportit	20.000 Lekë
34	Për të gjithë ata që bllokojnë kanalet kulluese apo vaditës me ndërtime të paligjshme të çfarëdo lloji	20.000 Lekë
35	Për mbrojtjen e mjedisit Mosdhënia e informacionit për shkarkimin dhe transferimin e ndotësve nga operatori, duke i shkarkuar në vënde jo të caktuara nga Bashkia dhe në bazë të lejes mjedisore	20.000 Lekë

Shënim: Kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon çdo drejtorie përgjegjëse për zbatim.

CamScanner

Sqarim: Në rastet e kundravajtjeve të qarkullimit rrugor nga kundravajtës të ndryshëm, gjobat do të vendosen nga Inspektorët e Policisë Bashkiake bazuar në Ligjin Nr. 8378, Datë 22.07.1998 " *Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar. Ligji nr. 8224, Datë 15.05.1997 "Për Policinë Bashkiake" i ndryshuar, Neni 24.

A.3.12 GJOBA PËR MOSSHLYERJE NË AFAT TË DETYRIMEVE

Baza ligjore: Ligji Nr. 9920, Datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, KREU XIV, Neni 114, Pika 1. Ligji Nr.9632, datë 30.12.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, Neni 5, Pika c.

Struktura përgjegjëse për llogaritjen dhe Arkëtimin: Ç'do drejtori që ka detyrim arkëtimin e taksës dhe tarifës, me përjashtim të rasteve kur ligji e parashikon ndryshe.

Gjobat aplikohen vetëm për subjektet e tatueshme (që kanë detyrim pajisjen me NIPT). Afati i fundit për likuidimin e detyrimit vjetor të vitit aktual është data 30 qershor e po këtij viti, ndërsa subjektet që operojnë në fushën e turizmit në vijën bregdetare është data 30 shator duke qënë se janë sezonal dhe normalisht hapin aktivitetin më vonë. Baza e llogaritjes së gjobës për mosshlyerje përfshin detyrimet totale të gjithë vitit aktual që lindin nga tarifat e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, tarifa e shërbimeve, taksa e tabelës për qëllime identifikimi, taksa e ndërtesës, taksa e truallit, etj, sipas faturës për pagesë. Subjektet e reja si dhe adresat sekondare të çelura rishtazi kanë afat deri në 30 qershor për shlyerjen e detyrimit. Nëse çelja bëhet pas datës 30 qershor, afati i fundit për shlyerjen e detyrimeve tatimore është 30 ditë pas datës së regjistrimit.

Tabela.27 Niveli i gjobave për mosshlyerje në kohë të detyrimeve tatimore.

Kategoritë	**Niveli i gjobës**
a)Gjoba për mosshlyerje të detyrimeve tatimore (taksa,tarifa) për biznesin pas datës 30 Qershor të vitit ushtrimor (kalendarik), 30 shtator bizneset sezonal që operojne në vijën bregdetare (beachbar, hoteleri e të ngjashme).	0.06% në ditë e vlerës së detyrimit, jo më shumë se 365 ditë kalendarike.

CamScanner